

UDHËZIM
Nr. 271, datë 1.7.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR APLIKIM PËR FITIMIN,
RIFITIMIN DHE HEQJEN DORË NGA SHTETËSIA SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, ministri i Brendshëm dhe ministri i Ekonomisë dhe Financave

UDHËZOJNË:

1. Tarifat e shërbimit që do të aplikohen për personat që aplikojnë për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare me vendbanim në Republikën e Shqipërisë, janë si më poshtë:
 - a) tarifë për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare;
 - b) tarifë për aplikimin për rifitimin e shtetësisë shqiptare;
 - c) tarifë për aplikimin për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.
 2. Tarifat e shërbimit që do të aplikohen për personat që aplikojnë për heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë si më poshtë:
 - a) tarifë për aplikimin për rifitimin e shtetësisë shqiptare;
 - b) tarifë për aplikimin për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare;
 - c) tarifë për nxjerrje dokumenti nga regjistri elektronik.
 3. Tarifat e shërbimit (pagesat) për shërbimet e pikave 1 dhe 2, të këtij udhëzimi, përcaktohen në shtojcën nr. 1 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 4. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve administrative.
 5. Ngarkohen strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Brendshme për zbatimin e këtij udhëzimi.
 6. Çdo akt nënligjor që bie ndesh me këtë udhëzim shfuqizohet.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

SHTOJCA NR. 1

- A. Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga zyrat e aplikimit pranë Policisë së Shtetit:
1. Për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare: 10000 lekë;
 2. Për aplikimin për lënien e shtetësisë shqiptare: 10000 lekë;
 3. Për aplikim për rifitimin e shtetësisë shqiptare: 10000 lekë.
- B. Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga zyrat përkatëse pranë përfaqësive diplomatike:
1. Për aplikimin për lënien e shtetësisë shqiptare: 30 euro;
 2. Për aplikim për rifitimin e shtetësisë shqiptare: 30 euro;
 3. Nxjerrje dokumenti nga regjistri elektronik: 30 euro.

